

VENDIM
Nr. 657, datë 27.8.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM
LETRASH, TË LETËRMARRËVESHJES, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM, QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE TË GRANTIT TË
SIGURUARA NGA SEKRETARIATI I SHTETIT PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE
(SECO) TË QEVERISË ZVICERANE, NËN FONDIN E BESIMIT ME SHUMË
DONATORË, PËR FUQIZIMIN E KONTABILITETIT DHE TË MJEDISIT TË
MIRËBESIMIT NË EVROPËN JUGORE DHE AZINË QENDRORE, PËR
PROJEKTIN E ZHVILLIMIT TË KONTABILITETIT NË SEKTORIN PUBLIK,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 251, DATË 9.5.2018, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, datë 21.4.2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të letërmarrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të siguruar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) të qeverisë zvicerane, nën Fondin e Besimit me Shumë Donatorë, për fuqizimin e kontabilitetit dhe të mjedisit të mirëbesimit në Evropën Jugore dhe Azinë Qendrore, për projektin e zhvillimit të kontabilitetit në sektorin publik, miratuar me vendimin nr. 251, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Logo BANKA BOTËRORE
BNRZH – IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE
Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020

LINDA VAN GELDER
Drejtoreshë Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

30 qershor 2020

Drejtuar: SH.S.Znj. Anila Denaj
Ministres
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

E nderuar Znj. Ministre,

*Shqipëri – Zhvillimi i një Projekti Kontabiliteti në Sektorin Publik
SAFE Granti nr. TF0A3277 dhe SAFE Granti nr. TF0A5134
Zgjatja e Datës së Mbylljes*

I referohemi letërmarrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Marrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka Botërore”), e cila vepron si administratore e fondeve të grantit të ofruar nga Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO) i Qeverisë së Zvicrës (“Donatori”) sipas Fondit të Besimit me Shumë-Donatorë për Forcimin e Mjedisit të Përgjegjshmërisë dhe Mirëbesimit në Evropën Juglindore dhe Azinë Qendrore, datë 3 prill 2018, për Zhvillimin e Projektit të Kontabilitetit në Sektorin Publik (“Projekti”) dhe letrës suaj të datës 26 qershor 2020, me anë të së cilës Bankës Botërore i kërkohet zgjatja e Datës së Mbylljes të grantit të lartpërmendur të parashikuar sipas letërmarrëveshjes nga data 30 qershor 2020 deri më 31 dhjetor 2021.

Kemi kënaqësinë t’iu informojmë se Banka Botërore ka caktuar datën 31 dhjetor 2021 si datën më të vonshme për qëllime të nenit III, 3.03 të aneksit të letërmarrëveshjes.

Me respekt,

(Nënshkrimi)

Linda Van Gelder

Drejtoresha Rajonale për Ballkanin Perëndimor, Rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore

Për dijeni: Znj. Adela Xhemali, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë
Znj. Vasilika Vjero, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë
Z. Patrik Meier, zëvendëssof i Misionit, Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO)
Znj. Veronika Korkaj, drejtore e përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Kontraktimeve dhe Financimeve të Projekteve (GDCE), Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Znj. Majlinda Dhuka, zëvendëssekretare e përgjithshme dhe drejtore e përgjithshme e Departamentit për Zhvillimin dhe Qeverisjen e Mirë
Z. Patrizio Pagano, drejtor ekzekutiv, Banka Botërore

Tel: +43 (1) 2170 782

Faks: +43 (1) 2170 701